

## REVISTA “GJUHA SHQIPE” NË 50-VJETORIN E KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT

Abdurrahim MAXHUNI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Instituti Albanologjik, Prishtinë

---

### Përmbledhje

Revista “Gjuha shqipe”, organi i Instituti Albanologjik në Prishtinë, këtë vit shënoi 40-vjetorin e themelimit të saj. Instituti Albanologjik, në kuadër të aktivitetit të tij të përvitshëm “Java e albanologjisë” temë bosht në sesionin e gjuhësisë e kishte **Revista “Gjuha shqipe” – tribunë e rëndësishme për shqipen standarde dhe kulturën gjuhësore**. Në këtë konferencë referuan plotë 30 studiues nga treva të ndryshme shqiptare, të cilët e vunë në pah rëndësinë e kësaj reviste dhe përpjekjen e saj për ruajtjen e fjalës shqipe. Për gjatë këtyre viteve, revista ishte një derë e hapur për trajtimin e problemeve të ndryshme gjuhësore, ishte një tribunë e rëndësishme për kulturën e gjuhës. Në këtë kumtesë do të ndalemi tek disa nga problemet e trajtuar në këtë revistë, për të parë një reflektim nga ajo që është trajtuar dhe problemeve aktuale të kulturës së gjuhës.

**Fjalët kryesore:** *revistë, Gjuha shqipe, Kongresi i Drejtshkrimit, kulturë e gjuhës.*

---

### Hyrje

Kongresi i Drejtshkrimit ishte kuvend mbarëkombëtar, i cili për nga rëndësia historike, mund të krahasohet me Kongresin e Manastirit. Ky i fundit zgjidhi përfundimisht çështjen e alfabetit, ndërsa Kongresi i Drejtshkrimit zgjidhi çështjen e drejtshkrimit. Kongresi i Drejtshkrimit erdhi si rezultat i përpjekjeve të mëdha e të gjata, sidomos nga Rilindja e këndej. Ndonëse gjatë kësaj periudhe nuk u arrit përfundimisht të zgjidhej problemi i njësimimit të gjuhës, rilindësit lanë pas vetes bazë të fortë për të çuar përpara projektin kombëtar të njësimimit të gjuhës.

Përpjekjet e klasës intelektuale për një shqipe letrare vazhduan e nuk u ndalën asnjëherë. Përveç brenda Shqipërisë, ato u shtuan edhe jashtë saj, sidomos në Kosovë që kulmoi më 1968, me Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, që u organizua nga Instituti Albanologjik, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve shqiptarë nga të gjitha pjesët e ish-Jugosllavisë. Shkak i mbledhjes së saj ishte Botimi i Projektit të Tiranës, më 1967. Akademik Ajeti ishte pjesëmarrës në këtë Konsultë, ku lexoi referatin “*Rruga e njësimimit të gjuhës letrare shqipe dhe ortografisë së re*”, nga e cila dolën Konkluzat e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, ngjarje e cila i hapi rrugë Komisionit të Drejtshkrimit që t’i kapërcente propozimet e projektuara pa kurrfarë pengesash në Kongresin e Drejtshkrimit, më 1972.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Fadil Raka, *Historia e shqipes letrare*, Prishtinë, 2004, f. 234.

Vendimet e Kongresit të Drejtshkrimin, më 1972 u mirëpritën edhe në Kosovë. Për herë të parë, gjuha shqipe pas një rrugëtimi të gjatë u normëzua, dhe në të njëjtën kohë frika për ndarje gjuhësore u largua, duke bashkuar shqiptarët edhe më tepër, ndonëse jetonin në disa shtete jashtë trungut të saj. Kongresi ishte arritja më e madhe e shqiptarëve në fushën e kulturës, e cila me ngjarjet që i paraprinë ndoqi një rrugë të natyrshme për t'u kurorëzuar, siç shprehet profesor Ajeti: “është e vërtetë e madhe dhe e rëndësishme që njësimi i gjuhës letrare në të gjitha trojet e shqipes, ka qenë rezultat i natyrshëm i proceseve të shoqërisë shqiptare veçanërisht nga Rilindja e këndej, - e vërtetë që, e mbështetur fuqishëm nga vendimi historik i Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968), u kurorëzua me Kongresin e Drejtshkrimin (Tiranë, 1972)”.<sup>2</sup>

Në Kosovë, 10 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimin, ishin shënuar rezultate të kënaqshme, në përvetësimin e normës letrare, megjithatë kishte akoma të meta e dobësi, të cilat kërkonin një angazhim më të madh shkencor për mënjanimin e tyre dhe për stabilizimin e normës letrare. Duke e parë gjendjen praktike të përdorimit të shqipes standarde, Instituti Albanologjik mori vendim të themelonte një revistë, e cila do të ndihmonte në përvetësimin e rregullave drejtshkrimore, të cilën e emërtoi “Gjuha shqipe”.

Revista doli në kohën kur ndodhnin ndryshime të mëdha në Kosovë, në të gjitha fushat e veprimtarisë kulturore, arsimore e ekonomike. Të gjitha këto ndryshime reflektonin edhe në gjuhë si mjet komunikues. Për çdo emërtim të ri, të ndikuar nga zhvillimi i hovshëm kërkohej fjalë e re, e cila duhej të ishte në përputhje me natyrën e gjuhës shqipe. Pasurimi e pastrimi i leksikut të shqipes me fjalë të reja ishte një detyrë, të cilën kjo revistë synonte ta përmbushte. Redaksia ishte e bindur se kjo revistë do të ndihmonte përvetësimin e stabilizimin e gjuhës letrare dhe zgjerimin e kulturës së gjuhës, që është bazë për zgjerimin e çdo veprimtarie tjetër kulturore e shoqërore në përgjithësi.

Revista nisi rrugëtimin e saj nën përkujdesjen dhe përkushtimin e bashkëthemeluesit dhe kryeredaktorit të saj të parë, profesor Idriz Ajetit, dhe rreth saj vazhdimisht kishte një redaksi me emra të njohur. Ndonëse rrethanat politike, nën presionin e pushtetit okupues serb, ishin të rënduara, redaksia e revistës ishte e vendosur të vazhdonte punën e saj. Për 40 vjet, revista “Gjuha shqipe” ishte tribunë e rëndësishme e problemeve të ndryshme të kulturës së gjuhës dhe të shqipes standarde në përgjithësi.

Më 1982 revista doli vetëm një herë. Nga viti 1983-1989 dolën nga tre numra në vit. Më 1990 doli një numër, ndërsa nga viti 1991-1996 për shkak të rrethanave të krijuara nga pushteti serb, revista nuk doli. Pas kësaj ndërprerje botimi i revistës rinisi nga viti 1997 me nga një numër, ndërsa në vitet 2000-2003 janë botuar dy numërsha, ndërsa nga 2005 vijon të dalë e rregullt, me tre numra në vit.

Gjatë kësaj kohe, në faqet e kësaj reviste janë botuar 1320 njësi bibliografike, të përfshirë brenda 86 numrave. Njësitë bibliografike përfshijnë: studime, artikuj, kronika, materiale, recensione, përvjetorë, bibliografi, intervista etj. Në këtë revistë botuan emra të njohur, si: Idriz Ajeti, Shaqir Berani, Besim Bokshi, Rexhep Ismajli, Fadil Raka, Latif Mulaku, Fadil Sulejmani, Rexhep Qosja, Agim Vinca, Shefkije Islamaj, Qemal Murati, Ragip Mulaku, Hysen Matoshi, Jani Thomai, Emil Lafe, Xhevat Lloshi, Hajri Shehu, Rami Memushaj, Gjovalin Shkurtaç, Mehmet Çeliku, Valter Memisha, Tomor Osmani, Agron Duro, Anila Omari, Kristina Jorgaqi, Bahtijar Kryeziu, Begzad Baliu, Ardian Vehbiu, Viktor Bakillari, Abdurrahim Maxhuni, Naim Berisha, Sejdi Gashi, Shpresa Ismajli, Faton Krasniqi, Vjosa Osmani e shumë emra të tjerë.

---

<sup>2</sup> Idriz Ajeti, *Kontestohen, heshtur dhe zëshëm, vendimet për gjuhën*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1-2/2002, f. 23.

Në rubrikën *Studime e artikuj*, e cila trajton kryesisht çështje teorike janë botuar 701 punime të temave që lidhen me historinë e gjuhës shqipe, rëndësinë e Kongresit të Manastirit, të Komisionit Letrar të Shkodrës, të rëndësisë së Konsultës Gjuhësore të Prishtinës dhe ngjarjeve të tjera që i paraprin Kongresit të Drejtshkrimit, të rëndësisë së vetë Kongresit dhe vendimeve të tij, rreth marrëdhënieve të shqipes me gjuhë të tjera ballkanike, rreth rëndësisë së shkrimeve të vjetra, rreth rrugës drejt njësimin të shqipes, rreth problemeve që lidhen me terminologjinë, dhe rreth çështjeve të ndryshme që lidhen me fjalorët e gjuhës shqipe, rreth ndihmesës së autorëve të ndryshëm për gjuhën shqipe, sidomos atyre të Rilindjes Kombëtare etj. Vend të madh kanë zënë edhe problemet e zbatimit të normës në Maqedoninë e Veriut si dhe statusit të gjuhës shqipe në këtë vend.

Disa nga punimet e kësaj rubrike mund t'i veçojmë: Emil Lafe, *Kongresi i Drejtshkrimit – kuvend shkencor mbarëkombëtar, gjuha letrare dhe shqetësimi ynë*,<sup>3</sup> Fadil Raka, *Fillet e zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare*,<sup>4</sup> Hajri Shehu, *Për një fjalorë drejtligjërimit të gjuhës shqipe*,<sup>5</sup> Idriz Ajeti, *Raportet e shqipes me gjuhët ballkanike*,<sup>6</sup> Rexhep Ismajli, *Emri i shqiptarëve*,<sup>7</sup> Isa Bajçinca, *Komisija Letrare shqipe e Shkodrës dhe shkrimi i shqipes*,<sup>8</sup> Qemal Murati, *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare*,<sup>9</sup> Shefkije Islamaj, *Konsulta Gjuhësore 1968 – marrëveshje për njësimin gjuhësor*.<sup>10</sup>

Meqenëse interesimi kryesor i revistës ishte ngritja e nivelit të zbatimit të vendimeve të Kongresit, në revistë botoheshin çështje praktike të kulturës së gjuhës. Në mesin e disa rubrikave të revistës është edhe *Gjuha në praktikë*. Duke u nisur edhe nga vetë emërtimi i kësaj rubrike, si duket se në këtë rubrikë përfshihen çështje praktike të kulturës së gjuhës, si përdorimi i drejtë i nyjave, i përemrave, i emrave, i ndajfoljeve, pastaj përdorimi i fjalëve të huaja, përdorimi i kalkeve, përdorimi i shqipes standarde në medie të shkruara e televizive etj. Vëmendje e madhe i është kushtuar huazimeve të dy dekadave të fundit, në gjuhën shqipe, sidomos atyre nga anglishtja. Përmes shkrimeve të ndryshme u është bërë thirrje gazetarëve, redaktorëve, përgjithësisht mediave të shkruara edhe atyre elektronike që të mënjanojnë nga përdorimi fjalët e konstruktet e huaja, ta ruajnë gjuhën shqipe, si vlerën më të çmuar të kombit shqiptar.

Kjo revistë, në vazhdimësi e ka qenë e përkushtuar në ruajtjen e vlerave gjuhësore dhe ngjarjeve të mëdha, fillimisht nga ndikimet e gjuhësore të serbishtes, por edhe të gjuhëve të tjera, qofshin ndikime në fjalësin e tij, apo edhe përmes kalkeve e formimeve jo të natyrës së shqipes. Ndërsa, me nxjerrjen krye të mendimeve për një rishikim, për një ndryshim, madje edhe për rrënim të standardit të shqipes, redaksia e revistës së bashku me bashkëpunëtorët anëmbanë trojeve shqiptare u bë derë e hapur në mbrojtje të standardit. Vargut të studiuesve që botuan punime të mirëargumentuara e të shtrura në mënyrë shkencore, në faqet e revistës “Gjuha shqipe”, në mbrojtje të vendimeve të Kongresit mund t'i përmendim: Emil Lafe *Standardi*

<sup>3</sup> Emil Lafe, *Kongresi i Drejtshkrimit – kuvend shkencor mbarëkombëtar, gjuha letrare dhe shqetësimi ynë*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1-2/2002, f. 16-31.

<sup>4</sup> Fadil Raka, *Fillet e zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2-1986, f.1-9.

<sup>5</sup> Hajri Shehu, *Për një fjalorë drejtligjërimit të gjuhës shqipe*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 3/2013, f. 67-74.

<sup>6</sup> Idriz Ajeti, *Raportet e shqipes me gjuhët ballkanike*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 2/1984, f. 5-13.

<sup>7</sup> Rexhep Ismajli, *Emri i shqiptarëve*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 3/1985, f. 5-10.

<sup>8</sup> Isa Bajçinca, *Komisija Letrare shqipe e Shkodrës dhe shkrimi (standardi) i shqipes*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 3/2016, f. 137-145.

<sup>9</sup> Qemal Murati, *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 2/2012, f. 15-26.

<sup>10</sup> Shefkije Islamaj, *Konsulta Gjuhësore 1968 – marrëveshje për njësimin gjuhësor*, në revistën “Gjuha shqipe”, 2/2008, f. 20-35.

*gjuhësor-rruga e parë e kombit*,<sup>11</sup> Gjovalin Shkurtaj *Të ngulim këmbë ta mbrojmë këtë standard, të mos lejojmë që të prishet*,<sup>12</sup> Qemal Murati *Mëtimet për ristandardizimin e shqipes – eufori pseudofilologjike*<sup>13</sup>, Shefkije Islamaj *Gjuha e përbashkët letrare-zgjidhje e vetme për shqiptarët*,<sup>14</sup> Ragip Mulaku *Standardi i shqipes përballë debateve kontestuese*,<sup>15</sup> Hysen Matoshi<sup>16</sup>, Rexhep Qosja *Gjuha standarde midis dy frontesh*,<sup>17</sup> Xhevat Lloshi *Nga gjuha e normuar prej Kongresit të Drejtshkimit (1972) te një anarki gjuhësore*,<sup>18</sup> Rami Memushaj *Gjuha standard krijesë kombëtare, jo totalitare*,<sup>19</sup> Valter Memishaj *Standardi nuk është gjithëpërfshirës, por është përzgjedhje*,<sup>20</sup> Mehmet Çeliku *Mos prekni Drejtshkrimin, të ngrihet Këshilli Kombëtar*,<sup>21</sup> Aristotel Spiro, Begdaz Baliu, Çlirim Bidollari, Edmond Tupja, Enver Hysa, Kujtim Kapllani e shumë të tjerë.

Këtu, mund të sjellim mendimin e studiueses Islamaj,<sup>22</sup> e cila në mbyllje të shkrimit të saj shprehet se nuk ka zgjidhje tjetër gjuhësore për shqiptarët, përpos gjuhës së përbashkët letrare. Standardi është i domosdoshëm dhe nuk ka zgjidhje tjetër për shqiptarët. Çdo përmbysje në këtë rrafsh, çdo ndryshim rrënjësor, çdo copëzim gjuhësor i shqiptarëve, mund të sjellë pasoja të paparashikueshme. Çdo rrënim i normave të qëndrueshme do të hapë probleme të tjera, që nuk do të mund të quheshin më probleme gjuhësore.

Falë ndihmës së këtyre bashkëpunëtorëve, në faqet e revistës është krijuar një bazë e shëndosh shkencore, e mbështetur në argumente gjuhësore e historike, me një metodologji të shtruar drejt se pse standardi i shqipes është arritja më e madhe dhe pse nuk duhet të preket baza e tij, përveç disa ndryshimeve, për të thjeshtësuar zbatimin e drejtshkrimit dhe hapjen e tij ndaj leksikut dialektor e terminologjik, i cili është zhvilluar shumë në dy dhjetëvjeçarët e fundit.

---

<sup>11</sup> Emil Lafe, *Standardi gjuhësor-rruga e parë e kombit*, në revistën “Gjuha shqipe, nr.1/2016, Prishtinë, f. 86.

<sup>12</sup> Gjovalin Shkurtaj, *Të ngulim këmbë ta mbrojmë këtë standard, të mos lejojmë që të prishet*, në revistën “Gjuha shqipe nr.2/2017, f. 11-18.

<sup>13</sup> Qemal Murati, *Mëtimet për ristandardizimin e shqipes – eufori pseudofilologjike*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.3/2008, f. 5-10.

<sup>14</sup> Shefkije Islamaj, *Gjuha e përbashkët letrare-zgjidhje e vetme për shqiptarët*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2/2004, Prishtinë, f.17-23.

<sup>15</sup> Ragip Mulaku, *Standardi i shqipes përballë debateve kontestuese*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1-2012, f. 29-36.

<sup>16</sup> Hysen Matoshi, *Gjuha standarde shqipe dhe njësia kombëtare*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.3/2013, f. 45-48.

<sup>17</sup> Rexhep Qosja, *Gjuha standarde midis dy frontesh*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2-2010, f. 5-10.

<sup>18</sup> Xhevat Lloshi, *Nga gjuha e normuar prej Kongresit të Drejtshkimit (1972) te një anarki gjuhësore*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1/2017, f. 53-60.

<sup>19</sup> Rami Memushaj, *Gjuha standard krijesë kombëtare, jo totalitare*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2/2011, Prishtinë, f.19.

<sup>20</sup> Valter Memisha, *Standardi nuk është gjithëpërfshirës, por është përzgjedhje*, në revistën “Gjuha shqipe”, 2/2020, Prishtinë, f. 44.

<sup>21</sup> Mehmet Çeliku, *Mos prekni Drejtshkrimin, të ngrihet Këshilli Kombëtar*, në revistën “Gjuha shqipe” nr. 3-2012, Prishtinë, f. 108.

<sup>22</sup> Shefkije Islamaj, *Gjuha e përbashkët letrare-zgjidhje e vetme për shqiptarët*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2/2004, Prishtinë, f.17-23.

## Në vend të përfundimit

Revista “Gjuha shqipe”, edhe sot e kësaj dite vazhdon të trajtojë tema të problemeve të shqipes së sotme standarde, të diskutimeve të kësaj kohe që kërkojnë zgjidhje të reja, tema që lidhen me ndërgjegjësimin e shoqërisë në përgjithësi, të gazetarëve, të redaktorëve, të mësimeve, të studentëve e të nxënësve në veçanti, duke i kushtuar artikuj të ndryshëm për shkarjet nga norma, për përdorimin e fjalëve të huaja, për zotërimin dhe zbatimin e rregullave drejtshkrimore të shqipes standarde si një vlerë e veçantë e kombit shqiptar.

Redaksia e revistës është kujdesur, qysh nga fillimi, të afrojë një numër të madh bashkëpunëtorësh jo vetëm nga Kosova, por edhe nga Shqipëria, Mali i Zi e Maqedonia e Veriut, gjë që dëshmon për orientimin e Instituti Albanologjik për lidhje të ngushta bashkëpunimi, siç shprehet profesor Lafe “për të përballur së bashku detyrat tona, si gjymtyrë të një trupi të vetëm”.<sup>23</sup>

Andaj, këtë vit, për gjuhën shqipe janë dy përvjetorë të rëndësishëm, ky që po e shënojmë sot, 50-vjetori i Kongresit dhe 40-vjetori i revistës “Gjuha shqipe”, i cili u shënuar në kuadër të aktivitetit të përvitshëm të Institutit Albanologjik “Java e albanologjisë”.

## Literatura

- [1]. Abdurrahim Maxhuni, *Bibliografia e revistës “Gjuha shqipe” 1982-2022*, IAP, Prishtinë, 2022.
- [2]. Idriz Ajeti, *Kontestohen, heshtur dhe zëshëm, vendimet për gjuhën*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1-2/2002, f. 23-24.
- [3]. Idriz Ajeti, *Raportet e shqipes me gjuhët ballkanike*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 2/1984, f. 5-13.
- [4]. Emil Lafe, *Kongresi i Drejtshkrimit – kuvend shkencor mbarëkombëtar, gjuha letrare dhe shqetësimi ynë*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1-2/2002, f. 16-31
- [5]. Fadil Raka, *Historia e shqipes letrare*, Prishtinë, 2004, f. 234.
- [6]. Fadil Raka, *Fillet e zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2-1986, f.1-9.
- [7]. Hajri Shehu, *Për një fjalorë drejtligjërimit të gjuhës shqipe*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 3/2013, f. 67-74.
- [8]. Isa Bajcinca, *Komisija Letrare shqipe e Shkodrës dhe shkrimi (standardi) i shqipes*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 3/2016, f. 137-145.
- [9]. Hysen Matoshi, *Gjuha standarde shqipe dhe njësia kombëtare*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.3/2013, f. 45-48.
- [10]. Mehmet Çeliku, *Mos prekni Drejtshkrimin, të ngrihet Këshilli Kombëtar*, në revistën “Gjuha shqipe” nr. 3-2012, Prishtinë, f. 107-110.
- [11]. Qemal Murati, *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 2/2012, f. 15-26.
- [12]. Rami Memushaj, *Gjuha standard krijesë kombëtare, jo totalitare*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2/2011, Prishtinë, f.19-26.
- [13]. Ragip Mulaku, *Standardi i shqipes përballë debateve kontestuese*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1-2012, f. 29-36.
- [14]. Rexhep Ismajli, *Emri i shqiptarëve*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr. 3/1985, f. 5-10.
- [15]. Rexhep Qosja, *Gjuha standarde midis dy frontesh*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2-2010, f. 5-10.
- [16]. Shefkije Islamaj, *Konsulta Gjuhësore 1968 – marrëveshje për njësimin gjuhësor*, në revistën “Gjuha shqipe”, 2/2008, f. 20-35.
- [17]. Shefkije Islamaj, *Gjuha e përbashkët letrare-zgjidhje e vetme për shqiptarët*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.2/2004, Prishtinë, f.17-23.
- [18]. Xhevat Lloshi, *Nga gjuha e normuar prej Kongresit të Drejtshkrimit (1972) te një anarki gjuhësore*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1/2017, f. 53-60.
- [19]. Valter Memisha, *Standardi nuk është gjithëpërfshirës, por është përzgjedhje*, në revistën “Gjuha shqipe”, 2/2020, Prishtinë, f. 44.
- [20].

---

<sup>23</sup> Emil Lafe, *Standardi gjuhësor-rruga e parë e kombit*, në revistën “Gjuha shqipe”, nr.1/2016, Prishtinë, f. 86.